



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 55/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Hasan Shala dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, për shkak të parregullsive gjatë fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetarë në Komunën e Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 26.04.2012, mori këtë:

## V E N D I M

Refuzohet ankesa si e pabazuar.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datën 24.04.2012, nga subjekti politik LDK, me të cilën pretendohet se në spotin e subjektit politik PDK për Kryetar të Komunës së Ferizajt është një sentencë e vitit 1999, kur është votuar për Kryesues të Kuvendit Komunal, në të cilën shihet duke votuar shefi i Grupit Parlamentar të subjektit politik LDK, Faruk Guri.

Parashtruesi i ankesës kërkon në mënyrë urgjente që të hiqet kjo sentencë, nga spoti i subjektit politik i PDK, me propozim që të ndërmerren masat e parapara ligjore ndaj subjektit politik të PDK.

**Neni 118 paragrafi 1 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), përcakton:**

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.*

PZAP-i, pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

**- ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se ankesa është e pabazuar, për faktin se nuk i përmban elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, ngase parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë për t'i argumentuar pretendimet ankimore andaj në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 55/2012 më datën 26.04.2012.

**Kryesuesi i panelit  
Ymer Hoxha**

